

## ALBANIAN OF THE TWENTY–FIRST CENTURY SHQIPJA E SHEKULLIT NJËZET E NJË

SHYKRANE GËRMIZAJ

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti I Filologjisë, Degae Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, Prishtinë, Kosova  
Shgermizaj@Yahoo.Com

AKTET V, 4: 731-735, 2012

### PËRMBLEDHJE

Shqipja po përballlet me gjuhët e tjera në kushte të kontakteve të drejtpërdrejta të përditshme, kurse ndikimi i gjuhëve të huaja, në veçanti e anglishtes, në radhë të parë në leksikon, por edhe në strukturën e shqipes, është në rritje të vazhdueshme. Shqipja vlon nga huazimet, kalket, akronimet, dhe transferet e kodit, por nuk mungojnë as strukturat e huaja. Për rrjedhojë, komunikimi po zhvillohet me pengesa të konsiderueshme. Në këtë studim, përmes shqyrtimit të ndikimit të burimeve të ndryshme të huaja në shqipen dhe analizës së prirjeve të sotme, autori mëton të pasqyrojë një gjendje hipotetike të shqipes së folur, në një të ardhme të afërt. Qëllimi përfundimtar i studimit është parandalimi i pasojave negative largvajtëse të qëndrimit tejet liberal të folësve burimorë të shqipes ndaj ndikimeve të huaja nga njëra anë, dhe nga ana tjetër qëndrimit të shkujdesur të tyre ndaj shqipes në përdorimet publike dhe private të saj.

**Fjalët kyçe:** anglishtja, kontakti, ndikimi, negativ, shqipja

### SUMMARY

Albanian is confronted with other languages in direct day-to-day contacts, whereas the influence of foreign languages, particularly of English, first and foremost on the lexis of Albanian, but also on its structure, is in constant increase. Albanian is marred with loan words, loan translations, acronyms, and code-switching, whereas foreign structures are not infrequent either. Consequently, communication is performed with considerable hindrance. In this paper, through the treatment of the influence of diverse foreign sources upon Albanian and analysis of the tendencies in the present day Albanian, the author aims to envision a hypothetical state of Albanian, particularly in the spoken language, in a near future. The ultimate aim of the study is the prevention of long-term negative consequences of excessively liberal attitude of the native speakers of Albanian toward foreign influence on the one hand, and on the other their neglectful attitude toward Albanian in its public and private uses. .

**Key words:** Albanian, English, contact, influence, negative.

---

### 1. Dy fjalë në vend të hyrjes

Dihet mirëfilli se shqipja që nga lashtësia ka qenë e ndikuar nga gjuhët në fqinjësi të saj dhe kjo është pasqyruar në masë të ndjeshme në radhë të parë në leksikon, por edhe në strukturën e saj. Mirëpo, në kohën tonë, falë lehtësisë së lëvizjes së njerëzve përkatësish të ndryshme etnike dhe kulturore dhe zhvillimit të teknologjisë, shqipja është në kontakt të vazhdueshëm me një varg gjuhësh gjeografikisht jo shumë të afërta. Përveç kësaj rol tejet të rëndësishëm për hapjen e

rrugëve për ndikime të jashtme në shqipe s'do mend ka krijimi i realiteteve të reja gjeopolitike e socioekonomike në nënqiellin dhe arealin tonë gjuhësor (Gërmizaj, 2008: 241).

Motivi i drejtpërdrejtë për ta hulumtuar këtë çështje ishte një dialog i shkurtër i regjistruar i cili u transmetua si pjesë e një programi argëtues. Ky dialog i shkurtër më shtyri ta hulumtojë çështjen e ndihmesës, apo të pengesës që paraqet anglishtja në komunikimin në shqipe.

Ky studim mëton ta hetojë çështjen e ndikimit të gjuhëve të tjera në shqipen, sidomos të anglishtes, jo në rrafshin diakronik, por në atë sinkronik, me qëllim të vlerësimit të drejtë të gjendjes në shqipen e sotme dhe parashikimin e prirjeve në të ardhmen duke synuar parandalimin e pasojave negative.

## 2. Korpusi dhe metodologjia

Korpusi i studimit, duke pasur parasysh aspektin gjithpërfshirës, përbëhet nga të dhëna të mbledhura nga programet e folura televizive, që u dedikohen jo një grupmoshe të caktuar, por grupmoshave të ndryshme e që transmetohen në televizionet kablore të Shqipërisë (ALSAT, Albanian Screen, Vision PLUS), të Kosovës (RTK, KTV, TV21, KLAN KOSOVA) dhe të Maqedonisë (ALSAT M), si dhe nga bisedat e rastit që janë regjistruar nga autorja.

Duhet theksuar faktin se vjelja e të dhënave që do të përzgjidheshin për korpusin e këtij studimi, nuk doli të ishte proces i mundimshëm pasi që burimet e përzgjedhura ofronin material të begatë. Po të shikohen vetëm emërtimet e disa kanaleve televizive që transmetohen përmes televizionit kabllor, del se edhe ato do të mund të shfrytëzoheshin si material i vlefshëm për analizë gjuhësore. E njëjta mund të thuhet edhe për emërtimet e rubrikave dhe të programeve të ndryshme televizive, të cilat po ashtu pasqyrojnë ndikimin e gjuhëve të huaja në shqipen (khs. Amazing b'e Njeri, Automan, Express, Interaktiv, Aldo Morning Show, OOPS, Promozone, Pro et Contra, Target, etj.).

## 3. Veçoritë e shqipes së folur të shekullit tonë – burimet, shkaqet dhe rrjedhojat

Pas analizës së hollësishme të korpusit të vjelë për qëllimet e këtij hulumtimi del qartë se shqipja vlon nga huazimet që janë shtresëzuar në leksikon e saj, mirëpo krahas tyre vazhdimisht depërtojnë edhe huazime të reja, në veçanti anglicizma të cilët prijnë në numër e denduri përdorimi. Kur kihet parasysh fakti, që u dëshmuar me një hulumtim të udhëhequr nga autorja e këtij studimi, se në periudhën e pasluftës për çdo vit në shtypin ditor kosovar depërtojnë

mesatarisht rreth shtatëdhjetë anglicizma të rinjë, si dhe faktin se gjuha e folur është më e hapur ndaj ndikimeve të jashtme, duket se hovi i dukurisë nuk ka të ndalur. Si rrjedhojë e gjendjes së tillë, komunikimi shpesh realizohet me vështirësi e pengesa natyrash të ndryshme. Kjo rezulton me moskuptime, keqkuptime dhe keqinterpretime. Por, ajo që ma merr mendja se duhet të nënvizohet në veçanti janë rastet në të cilat folësit burimorë të shqipes pengesat në komunikim përpiqen t'i kapërcejnë përmes anglishtes, dhe, për habi, ia dalin! Një ilustrim i qartë i këtij pohimi është një dialog mes moderatorit dhe mysafirit në një program argëtues:

A: *A jeni beqarëshë?*

B: *(Hesht, nuk jep përgjigje)*

A: *A jeni single?*

B: *Jo, nuk jam single. Jam e fejuar...*

dhe një tjetër i regjistruar në rrethana më joformale:

A: *Çka është pulëbardha?*

B: *Seagul.*

A: *Ah, po...*

Në shqipen e folur, sikurse edhe në atë të shkruar, krahas huazimeve nuk mungojnë as kalket. Pasi që vargu i tyre është i stërgjatë kurse renditja e tyre del nga suazat parësore të këtij punimi, po e përmend vetëm një rast. Rishtazi u hap një punëtori në njërën nga shkollat e mesme të Komunës së Prishtinës dhe lajmi u transmetua përmes televizionit. Lajme të tilla transmetohen shumë shpesh në programet televizive: '*... filloi punëtorja me OJQ-të...*' '*...u mbajtë punëtorja me temën...*' '*...nis punëtorja treditore në Kosovë...*'

Po të mos ishte lajm i përcjellë me pamje të filmuara nga kjo ndodhi, po të transmetohej përmes radios ose përmes medieeve të shtypura, pak kujt do ti shkonte mendja se bëhet fjalë për një uzinë të vogël ku do të përpunohet ushqimi si pjesë e praktikës profesionale e nxënësve të shkollës përkatëse. Keqinterpretimi i këtij lajmi burimin do ta kishte te kalku **punëtori** nga fjala angleze **workshop** e cila ka hyrë në përdorim në vitet e para të pasluftës dhe ka arritur të shtrihet në përdorim në atë masë sa që ka nxjerrë nga përdorimi pothuaj plotësisht fjalën **punëtori** me

kuptimin e drejtpërdrejtë të saj '*repart pune me një ndërmarrje prodhimi*'

(<http://www.fjalori.shkenca.org>). Njëkohësisht është bërë një rivlerësim semantik i kësaj fjale dhe, për shkak të ngushtimit të kuptimit, brenda kësaj periudhe ajo është përdorur krahas huazimeve të tjera siç janë **trajnim**, huazim i ri, dhe **seminar**, i cili ka qenë në përdorim prej kohësh. Në këto rrethana, pa pamjet filmike, keqinterpretimi i lajmit do të ishte shumë i gjasëshëm.

Nga ana tjetër, shqipja e programeve të folura televizive që u kushtohen grupmoshave të ndryshme, përveç me huazime e kalke, karakterizohet edhe me transfere kodit dhe akronime (Gërmizaj, 2011: 749; Gërmizaj, 2007: 241) ndërkaq nuk mungojnë as struktura të huaja si pasojë e përkthimit të fjalëpërfjalshëm të teksteve nga anglishtja. Në raste të mungesës së fjalëve të barasvlershme, huazimi dhe transferimi i kodit duket të jenë mjete më të shpeshta për kapërcimin e vështirësive në përkthim (Gërmizaj, 2008: 246-248).

Përveç qëndrimit të tejskajshëm liberal të folësve burimorë të shqipes ndaj ndikimeve të huaja, burim tjetër i gjendjes së sotme në shqipen e folur është edhe kujdesi i pamjaftueshëm për përdorimin e gjuhës standarde në përdorimet publike të saj. Shkeljet e standardit në shqipen e folur janë të shumta dhe të përditshme dhe e kaplojnë si rrafshin fonologjik dhe morfologjik, ashtu edhe atë sintaksor. Në këtë kontekst duhet përmendur mospërdorimin e nyjës së shquar dhe të mbaresave rasore me emra të përveçëm (qofshin ata emra të përveçëm njerëzish apo emra gjeografikë). Nga ana tjetër, kryefjala e cila në shqipe mund edhe të mos shprehet në mënyrë eksplicite, ndodhë të përsëritet disa herë brenda fjalisë së njëjtë si pasojë e ndikimit të anglishtes. Në këtë mënyrë krijohen fjali që bien ndesh me sintaksën e gjuhës shqipe dhe, rrjedhimisht, janë të panatyrshme. Për ta ilustruar këtë dukuri, po e sjellim vetëm një shembull: **Tina** hyri brenda dhe **ajo** menjëherë e kuptoi se të gjithë e shikonin **atë**. *khs. Tina came in and she immediately understood that*

*everybody was looking at her* (Gërmizaj, 2005: 114).

Nga ana tjetër, pos elementeve të huaj, dialektizmat, krahinarizmat, lokalizmat janë bërë pjesë përbërëse e programeve të folura. Si pasojë e njohjes së pamjaftueshme të shqipes standarde, përemri vetor i vetës së tretë shumë **ata** duket se përfundimisht po tërhiqet nga përdorimi për t'ia lëshuar vendin formës përkatëse të gjinisë femërore, siç po ndodh edhe me përmerin pyetës **kush** që po ia zë vendin përemrave **cili/cila**.

Në veçanti është brengosës fakti se nuk janë vetëm programet rinore dhe argëtuese ato ku hetohen këto dukuri; në këtë aspekt as programet e lajmeve dhe ato që i kushtohen publikut të gjerë nuk paraqesin përjashtim. Padyshim se fjalët e këtyre shtresave të leksikut janë një pasuri e pamohueshme e leksikut të shqipes, mirëpo çfarë ndikimi kanë ato në përdorimet publike të saj? Cili stil dhe cili model komunikimi po promovohet?

Marrë në përgjithësi, modelet e komunikimit që hasen në programet televizive dhe ndiqen e përvetësohen janë tejet joformale për t'u cilësuar si komunikim publik. Kur kihet parasysh shtrirja dhe ndikimi i medieve elektronike dhe roli i tyre për informimin, por edhe edukimin dhe formësimin gjuhësor të publikut, për përhapjen e modeleve, qofshin ato pozitive ose negative, është e qartë se kujdesi individual dhe kolektiv për këto çështje është i pamjaftueshëm.

Si pasqyrohet jeta jonë e përditshme përmes gjuhës shqipe në këtë dhjetëvjeçar në këto rrethana?

E para e punës, po **dispersohe**mi në të gjitha anët. Fëmijët tanë kanë gjithë **komoditetin** dhe gjithë **fokusin** tonë. **Ato** gjithnjë janë si **target**. Mbase edhe **ekzagjerojmë** ndonjëherë duke u dhënë gjithë **suportin** dhe duke u ofruar **materialitetin e ekzagjeruar**. **Avash, avash** vjen një kohë, sidomos ajo në **teenage** kur të rinjtë vishen me roba **firmato** e me ndonjë **china-stuff** për t'u dukur sa më **cool**. Çdo gjë paguajnë **tax-free**, por nuk ia dijnë **kimetin**. **Ato** janë ose jo në **relationship**, pra janë **couple**, ose **single**. Punojnë

për *independencën* e tyre ekonomike, duke *targetuar* të arrijnë *evoluimin* e pavarësisë.

Kohën e kalojnë duke pyetur njëri tjetrin: *'Me çfarë e vret ditën?'* Nuk u mbetet tjetër pos *downloadimit* të filmave në *PC-të* e tyre, përkundër problemeve me *providera e hackera, I-phone, I-phona I-pada dhe I-toucha*. Kështu *ato* mësohen me një jetë *virtuale*, pasi nuk kemi siguruar një *ekuilibër* dhe nuk ua kemi treguar botën *reale*. Pasi që *ato* janë edhe një çik *vulnerabël*, kohë pas kohe duhet t'i *surprizojmë* me *kompromise aprincipiale dhe me ndonjë incentiv*. Pasi të kemi qenë *të determinuar* për t'i dhënë diçka, apo gjithçka, *çunit* apo *gocës* sonë, shpresojmë se ai ose ajo do *t'na japi back*. Të paktën të na thotë: *'Jeni more than great!'* Nëse kjo nuk ndodh, *do të ngrihen* një mori pyetjesh për ta zbuluar se ku kemi gabuar: *'Kush është investimi (që kam bërë e nuk po më kthehet)? 'Kush është problemi? 'Kush është shkolla sot? Gjithë reformat e kurrikulimit, kurrikulit, kurrikuleve dhe syllabuseve, nuk më ndihmuan për edukimin e fëmijëve!*

Ndërkohë merremi edhe me probleme *sociale*, të *komercit* dhe *industrializimit* të sotëm që vuan nga *imazhi* i qytetit të ashpër përplot *smog* dhe *trafik* të ngjeshur për shkak të *akcizës* së ulët dhe *mbipopullimit*, dhe me qytetarë *të intimiduar* që jetojnë në *qiellgërvishëse*. Disa nga ta vuajnë nga *obesiteti*, të tjerët nga *mbipesha*, që është *e justifikueshme*. Por na takon *t'i jutilizojmë* të gjitha mjetet që *situata* të ndryshojë. Do të organizojmë *evente* dhe *party* e *afterparty*. Do t'i ftojme *DJ-at, rockerat* e *rapparat* më të famshëm. Të ftuar do të jenë edhe *VIP-at, ICO-ja*, dhe përfaqësuesit e *GND-së*, apo *GDN-së*. Në *mathe* të futbollit *playerat* do të japin *maksimalen*, mbase ndonjëri do të përbetohet se *'po e bāj my best'*. Do të ketë edhe transmetim *live*, ose *në kohë reale* të *kompeticioneve* ndërkombëtare, por, për shkak të *difekteve*, nuk do të korrin fitore. Megjithatë, sapo *të konstituohet ekipi, formalisht do të instituojmë* ndonjë shpërblim për përpjekjet e tyre.

Çështjet *globale* po ashtu do të jenë burim *continuel* dhe *potent* i *stresit*. Do të mbahen *summite* të *G8, G20*, ku *Clinton* do të takojë

*Cameron dhe liderë të tjerë*. Ky i fundit do të bisedojë me *Bill Bratton*. Do të jepet dritë *jeshile* për *iniciativa* të tjera. Do të mbajmë, *workshope, punëtori, seminare e konferenca*, ku do të përqipemi të *sensitivizojmë opinionin*, të *invlojmë* dhe të *impenjojmë* sa më shumë *individë* për t'i *implementuar konkluzionet* dhe për të siguruar *angazhimin* sa më të madh për *progres* e *avancim* dhe përmirësim të *performancës*, dhe të cilësisë dhe *kualitetit* të jetës. Natyrisht nuk e harrojmë as shqipen. Për të debatohet në emisionin që titullohet *Target*. Ndërkohë ndonjë *moderator* do ta sjellë numrin *cinque-një-cinque-një-tre-cinque* për t'u njohur me *të rejat* jo në Itali, por në Shqipëri. Këto do t'ia *transmetojë kolegëve* të tij. *Telefonata* do të hapet me *'Tung!'* dhe do të përmbyllet me *'Ciao!'* ose me *'Bye!'*, apo *'Thanks njeri!'*

Ky tekst është sajuar nga korpusi i mbledhur, kurse ndërhyrjet e mia kanë qenë fare të pakëta, vetëm sa për t'i grupuar thëniet sipas kontekstit në të cilin janë regjistruar. Kam bindjen se tekstin do ta kuptonte edhe një i huaj që nuk e flet shqipen. Mirëpo, dyshoj shumë se atë do ta kuptonte një folës burimorë i shqipes që nuk njeh gjuhë të huaja, në veçanti anglishten. Pasi shqipja flitet në këtë mënyrë sot, a është vështirë të paramendohet si do të flitet pas një dhjetëvjeçari?

#### 4. Në vend të përfundimit

Nga të dhënat që u prezantuan në këtë studim, burojnë një mori pyetjesh:

- A po e humb shqipja betejën në përballje me anglishten si pasojë e shpërputhjes në fondin leksikor të këtyre dy gjuhëve, apo nga qëndrimi ynë ndaj saj?

- Çka mund të bëjmë ne, folësit burimorë të shqipes, që ta parandalojnë ndikimin e tejskajshëm të anglishtes mbi shqipen?

- Cili është roli i medieve elektronike në ruajtjen e shqipes dhe parandalimin e ndikimeve të huaja të dëmshme për shqipen?

Nëse në këtë mënyrë flasin folësit burimorë të shqipes të moshës madhore që e marrin përgjegjësinë e paraqitjes publike në programet tona televizive, kujtoj se të rinjtë nuk duhet të

fajësohen për mosnjohje të gjuhës standarde, mosdallim dhe përdorim të pavend të stileve të gjuhës,

Ne, gjuhëtarët, mund të bëjmë thirrje të parreshtura për kujdes më të madh dhe ekologjizim të gjuhës sonë, gjë që edhe na takon. Mirëpo, që përpjekjet tona të mos jenë shterpe duhet t'i kemi përkrahë mediet që do të përhapnin modelet përkatëse të përdorimit publik të gjuhës sonë, por edhe kujdesin dhe ndihmesën e gjithë folësve burimorë të shqipes në përpjekjet e përbashkëta që rregullat që janë në libra të gjejnë zbatim në jetën e përditshme.

### **Bibliografia**

GËRMIZAJ, Sh. (2011), Akronimet në diskursin e folur dhe të shkruar: *AKTET*, Revistë e Institutit Alb-Shkenca, Tiranë – Prishtinë - Shkup, Vëll. IV nr. 4: 745-750.

GËRMIZAJ, Sh. (2007), Formimet akronimike në gjuhën shqipe: *Seminari XXVI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, v.1. f. 241-258.

GËRMIZAJ, Sh. (2008), Kontaktet e anglishtes me shqipen – përparësitë dhe rreziqet: *Seminari XXVII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare*, Prishtinë, 27/1: 241-253.

GËRMIZAJ, Sh. (2005), *Translation Theory in the Classroom*, Prishtina.

[HTTP://WWW.FJALORI.SHKENCA.ORG](http://www.fjalori.shkenca.org) (nxjerrë me datën: 27 korrik 2011).